



KADASTRA FISKALE

BULETIN INFORMUES

Botimi I

21 DHJETOR 2021

Rreth nesh

Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë (DPTP) është person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për financat. Misioni kryesor është administrimi në nivel qendror nga pikëpamja ligjore dhe metodologjike e taksës vendore mbi pasuritë e paluajtshme.

Në strukturën e saj ka dy drejtori. **Drejtoria e Regjistrimit të Bazave të të Dhënave**, funksioni i së cilës është menaxhimi i vazhdueshëm i Regjistrimit Qendror të Bazës së Të Dhënave të pasurive të paluajtshme për të mundësuar akses të vazhdueshëm në këtë regjistër nga organet e vetëqeverisjes vendore me qëllim të përlllogaritjes dhe pagesës së taksës. **Drejtoria e Metodologjisë dhe Ligjore** ka në përgjegjësinë e saj udhëzimin ligjor dhe zbatimin e tij në efekt të përlllogaritjes dhe pagesës së taksës së pasurisë.

Në përmbushje të funksioneve të veta, DPTP ka përgatitur këtë buletin informues i cili do të dërgohet periodikisht për të informuar palët e interesuara mbi progresin dhe ecurinë e zbatimit të reformës.

Kuadri Ligjor

Ndryshimet e kuadrit ligjor janë realizuar në dy faza:

1. Ndryshimet në metodologji

Me qëllim thjeshtëzimin e rregullave dhe procedurave ekzistuese DPTP me asistencën e projektit ProTax Albania ka draftuar disa ndryshime në metodologjinë për taksën e ndërtesës.

Ndryshimet e metodologjisë u prezantuan për të gjitha bashkitë në një takim online të zhvilluar më 03.12.2021.

Në përmbushje të detyrimit mbi konsultimin publik, këto ndryshime u dërguan për konsultim ku u reflektuan komentet dhe sugjerimet nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, bashkitë nëpërmjet Shoqatës së Autonomisë Vendore dhe Këshilli Konsultativ i Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore.

Qeveria Shqiptare nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke datuar nga viti 2018, ka nisur zbatimin e reformës mbi taksën e pasurisë së paluajtshme.

Qëllimi i reformës është forcimi i bashkive në Shqipëri, duke rritur ndjeshëm të ardhurat e veta, me vlerësimin e taksës bazuar në vlerën e tregut.

Reforma po implementohet me mbështetjen e Agjencisë Suedeze të Taksave si dhe mbështetet nga Fondi Monetar Ndërkombëtar duke kontribuar në agjendën e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Në përfundim të procesit të konsultimit dhe të reflektimit ndryshimet në metodologji janë në proces miratimi nga Këshilli i Ministrave.

2. Ligji i ri për “Taksën e Pasurisë”

DPTP me asistencën e projektit ProTax Albania kanë filluar punën për draftimin e ligjit të ri. Ligji i ri do të përcaktojë konceptin e vlerës së tregut dhe do të përfshijë taksën mbi ndërtesat, truallin dhe tokën bujqësore.

Zhvillimi i Sistemit Informatik të Kadastrës Fiskale

Sistemi i Kadastrës Fiskale në fazën aktuale është në një stad të konsoliduar dhe nëpërmjet funksionaliteteve të tij përmbush të gjitha kërkesat për vlerësimin dhe taksim sipas kuadrit ligjor në fuqi. Megjithatë, po punohet për një version të ri të përditësuar i cili sjell një ri-organizim të bazës së të dhënave me qëllim rritjen e nivelit të informacionit si dhe regjistrimin e të dhënave të tokës në sistem.

Në këtë mënyrë, sistemi do të mundësojë taksimin e ndërtesave sipas metodologjisë bazuar në çmimet e referencës dhe taksimin e tokës bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”.

Shërbimi i Pagesës

Në funksion të sa më sipër mbi adresimin e plotë të taksimit nëpërmjet sistemit, shërbimi i pagesës është një element kyç në këtë proces.



Aktualisht, Sistemi i Kadastrës Fiskale ofron mundësi të regjistrimit të pagesave të kryera në institucionet bankare nëpërmjet rakordimit me thesarin. Gjithashtu, në ndihmë të këtij procesi, DPTP dhe ProTax Albania kanë nisur bashkëpunimin me Postën Shqiptare për të bërë të mundur pagesën edhe në filialet e kësaj të fundit.

Ky proces është një fazë të avancuar dhe ekspertët e IT janë duke testuar mënyrat e ndërlidhjes së dy sistemeve.

Ecuria e implementimit në bashki

Në kuadër të proceseve të reformës dhe implementimit të taksës së pasurisë, janë mbajtur disa takime vijuese online me përfaqësues nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Në fokus të këtyre takimeve ishte prezantimi i versionit të ri të Sistemit të Kadastrës Fiskale dhe hapat vijues për tu zbatuar, me qëllim taksimin nëpërmjet sistemit duke filluar nga viti financiar 2022.

Duke mos u kufizuar vetëm në aspektin e angazhimit të marrë nga bashkitë, DPTP ka organizuar disa takime të detajuara rreth punës në sistem nga Janari 2022. Ky angazhim shihet në dy procese:

-  Taksim përmes sistemit
-  Përditësim dhe regjistrim i të dhënave



Takim i dedikuar për proceset e ardhshme të punës

Qëllimi i këtij takimi ishte koordinimi final dhe përgatitjet e mëtejshme të punës në sistem duke filluar nga Janari 2022.

- Në këtë takim u ri-prezantua sistemi IT dhe regjistrimi i të dhënave të tokës në të.
- U prezantuan pritshmëritë ndaj qeverisjes vendore dhe angazhimi në nivel qendror. Në këtë aspekt është planifikuar një plan intensiv trajnimesh dhe vizitash.
- Takimi u mbyll me një diskutim të hapur ku secila palë adresoi problematikat, sugjerimet dhe u dhanë mënyrat e zgjidhjes së tyre.



Reforma e Taksës së Pasurisë kryhet pjesërisht përmes bashkëpunimit midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencisë Suedeze të Taksave. Bashkëpunimi zhvillohet përmes projektit të quajtur ProTax Albania.

Qëllimi i projektit është **fuqizimi i bashkive duke rritur të ardhurat e tyre vetjake**. Projekti synon administrim modern dhe uniform të taksës së ndërtesës, ku taksimi do të bazohet në vlerën e tregut. Një sistem i qendëruar IT, cilësi e përmirësuar e regjistrave dhe taksapagues të mirë informuar, së bashku me një kuadër ligjor modern pritet ta bëjnë taksimin më të drejtë dhe efikas.

ProTax Albania financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim.



**Ministria e Financave dhe
Ekonomisë**
Bulevardi Dëshmorët e
Kombit Nr.3, Tiranë



Alvaro.Bulku@financa.gov.al
Klaudia.Vukzaj@financa.gov.al
Valmira.Fejza@financa.gov.al
Eva.Hasa@financa.gov.al



<https://dptp.financa.gov.al>